



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. _____ prot.

Datë ____/____/ 2018

V E N D I M

Nr. 89 , Datë 05 / 04 / 2018

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, mbështetur në ligjin nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, mori në shqyrtim ankesën me nr.125 Regj, datë 22.09.2017, të një grupi¹ personash, përfaqësuar nga znj. F. C dhe z. E. D, kundër Bashkisë Tiranë, në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “*gjendjes ekonomike dhe të racës*”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I :

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas informacionit të dhënë, subjektet ankues në muajin Shtator 2015 kanë lidhur kontratë me Bashkinë Tiranë dhe aktualisht janë përfitues të banesave sociale. Kontratat janë lidhur në bazë të të ardhurave nga punësimi, ndihma ekonomike, pagesa e aftësisë së kufizuar dhe deklaratat e të ardhurave nga mbledhja e materialeve të riciklueshme. Më pas, të gjendur në pamundësi ekonomike për të shlyer detyrimet (për shkak të papunësisë, ndërprerjes së ndihmës ekonomike dhe ndalimit të veprimtarisë së riciklimit nga Bashkia Tiranë), nuk kanë mundur të paguajnë më qiranë e banesave dhe janë njoftuar nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve Sociale të Bashkisë Tiranë, për të paguar detyrimet e prapambetura. Në këto kushte, i janë drejtuar disa herë me shkresë zyrtare Bashkisë Tiranë për të vlerësuar situatën ekonomike të çdo familjeje dhe për t’i ofruar zgjidhje për këtë situatë. Në fillim të muajit shtator janë njoftuar nga ana e Bashkisë Tiranë, për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura ose në të kundërt do të duhet të dalin nga banesat brenda datës 30 Shtator 2017. Ankuesit ndjehen të diskriminuar për shkak të gjendjes ekonomike duke mos marrë paraysh asnjë nga kërkesat e ankuesve dhe duke rrezikuar kështu që familjet e tyre të mbeten të pastreha.

¹ S . M, A. N, N. Sh, M. K, R. S, R. M, L. L, A. H dhe Gj. S.

Në përfundim, ankuesit kërkojnë, të mos largohen nga banesat brenda afatit të caktuar dhe të bëhet një rivlerësim i situatës ekonomike të tyre.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10 221/2010, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Bazuar në nenin 32/1/c të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këtë shkak.

Përsa më lart, referuar nenit 33, të ligjit nr. 10 221/2010, ankesa përmban elementët e kërkuar nga ky ligj.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Me datën 26.09.2017 u krye inspektimi pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve Sociale, Bashkia Tiranë, me qëllim marrjen e informacionit lidhur me ankesën sipërcituar².

Gjatë takimit me Drejtoreshën e Përgjithshme të Shërbimeve Sociale, znj.A. R, inspektorët e Komisionerit u njohën me sqarimet e saj për situatën e krijuar me banorët e Banesave Sociale, Shkozë. Ajo informoi se që nga gjysma e muajit Gusht 2017 familjet debitore të Banesave Sociale, Shkozë, të cilat janë rreth 234 familje debitore, janë njoftuar nga ana e Bashkisë Tiranë lidhur me detyrimin për të shlyer detyrimet deri me datë 30.09.2017. Në pamundësi për të paguar detyrimet duhet të plotësojnë dokumentacionin përkatës dhe mund të aplikojnë për të përfituar nga bonusi i qirasë, i cili paguhet nga ana e Bashkisë deri në masën 100%. Gjithashtu Bashkia Tiranë u ka ofruar familjeve debitore mundësinë e pagesës me këste të vogla të detyrimeve të prapambetura, plus pagesën e muajit përkatës.

2. Në vijim të procedurës për shqyrtimin e mëtejshëm të ankesës, me datë 28.09.2017³, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, realizoi një seancë dëgjimore në ambjentet e Zyrës së Komisionerit.

² Shkresa me nr.915/1 prot., datë 25.09.2017 “Urdhër nr.112, datë 25.09.2017” e Komisionerit.

Bashkia Tiranë u përfaqësua në seancë nga Drejtorja e Përgjithshme e Shërbimeve Sociale, znj.A. R dhe Specialistja e Strehimit Social, znj.E. R. Pretendimet e palëve janë pasqyruar në procesverbalin e mbajtur gjatë seancës. U la detyrë për Bashkinë e Tiranës që parashtrimet dhe dokumentacionin provues për çdo subjekt ankues, ta dërgonin me postë.

Kështu, me shkresën me nr.34913/2 prot., datë 28.09.2017, Bashkia Tiranë informon Komisionerin lidhur me të dhënat specifike të subjekteve ankues: llojin e apartamentit, të ardhurat neto të tyre, qiranë e rekomanduar, qiranë mujore dhe masën e subvencionit të qirasë. Ndërsa, lidhur me rastin e znj.S. M Bashkia Tiranë informon se zonja është sistemuar në banesat sociale si rast emergjent për shkak të problemeve sociale të theksuara.

3. Në zbatim të Urdhërit nr.158, datë 02.11.2017, u realizua inspektimi në ambjentet e Drejtorisë së Përgjithshme nr.3 të Punëtorëve të Qytetit dhe në Drejtorinë e Administrimit të Banesave Sociale, Shkozë. Qëllimi i inspektimit ishte:
 - Marrja e informacionit mbi pretendimet e ngritura në ankesën nr. 125, datë 22.09.2017 nga ana e banorëve të Banesave Sociale Shkozë, Tiranë.
 - Shtetasit e sipërcituar a janë paraqitur për të aplikuar pranë Institucionit tuaj? Nëse po, një kopje të procedurës së mbajtur, për secilin aplikant.
 - Sa persona kanë aplikuar gjithsej për përfitimin e bonusit të qirasë? (Sa nga këto janë pjesëtarë të komunitetit rom/egjiptian)
 - Sa persona kanë rezultuar përfitues, në total? (Sa janë të komunitetit rom/egjiptian)
 - Sa nga ankuesit e cituar në shkresë kanë rezultuar përfitues? (Sa janë të komunitetit rom/egjiptian)
 - Një pasqyrë të debisë për secilin rast të ankuesve të cituar në shkresë.
 - Një kopje e praktikës së mbajtur me secilin aplikant të cituar në shkresë.
 - Kopje e VKB-së ku aplikantët e sipërcituar rezultojnë përfitues të programit të banesave me qira.
 - Informacion nëse znj.S. M (apo dhe ndonjë tjetër) është sistemuar në banesat sociale si rast emergjent për shkak të problemeve sociale të theksuara. Nëse po, një kopje të praktikës së mbajtur.

Parashtimet e Drejtorit të Drejtorisë së Administrimit të Banesave Sociale, Shkozë, pasqyrohen në procesverbalin e mbajtur nga ana e inspektorëve.

Gjatë takimit në zyrën e Drejtorisë së Administrimit të Banesave Sociale, Shkozë, u paraqit personalisht znj.S. M e cila kërkoi që të tërhiqej nga ankesa e grupit të personave, pasi citoi se nuk kishte shprehur ndonjë ankesë për rastin e saj. Ajo pohoi që i ishte ofruar strehim si rast emergjence dhe se në muajin pasardhës do të dorëzojë dokumentacionin përkatës për t'u bërë pjesë e programeve të strehimit social që ofron Bashkia e Tiranës.

³ Referuar njoftimit për seancën dëgjimore me nr.915/3 prot., datë 25.09.2017, të Komisionerit.

Me shkresën me nr.1966/1 prot., datë 10.11.2017 Drejtoria e Përgjithshme nr.3 e Punëtorëve të Qytetit, Bashkia Tiranë informon Komisionerin lidhur me situatën aktuale ekonomike të sejcilit subjekt ankues veçmas, duke bërë një pasqyrë të detajuar.

III. Në përfundim të procedurave të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri vëren se:

A. Lidhur me pretendimin e ankuesve se janë trajtuar në mënyrë të pafavorshme, të padrejtë dhe të pabararrantë nga ana e Bashkisë Tiranë, për shkak të gjendjes së tyre ekonomike.

Ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, neni 1 sipërcituar dhe neni 3/1, parashikojnë se: *“Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi”.*

Komisioneri konstaton se njoftimi i bërë nga ana e Drejtorisë së Administrimit të Banesave Sociale Shkozë, me datë 30.09.2017 është bërë konform parashikimeve ligjore të ligjit nr.9232/2004 “Për programet sociale të strehimit”, i ndryshuar dhe të kontratës individuale të qirasë. Më poshtë po citojmë specifikisht:

Neni 6 i ligjit përcakton se: *“ 1.Qiramarrësi detyrohet t’i paguaj qiradhënësit gjatë kohëzgjatjes së kontratës detyrimin mujor, të përcaktuar me VKB. 2. Pagesa e qirasë do të kryhet deri në datën 5(pesë) të çdo muaji”.*

Neni 9 citon se: *“...8.Qiradhënësi ka të drejtë të kërkojë zgjidhjen e kontratës së qirasë para afatit të përcaktuar në kontratë, kur qiramarrësi shkel detyrimet e marra përsipër, njoftim ky i bërë 15 ditë përpara. 9.Qiradhënësi ka të drejtën e njoftimit të Policisë Bashkiake për lirim të pasurisë nga qiramarrësi në momentin e zgjidhjes së kontratës ndërmjet palëve”.*

Këto detyrime janë të përcaktuara edhe në Kontratën individuale të qirasë.

Komisioneri ka analizuar situatën e secilit ankues, rast pas rasti.

- **Znj.S. M** është tërhequr nga ankesa e saj dhe për këtë arsye Komisioneri nuk shprehet për pretendimin e saj⁴.
- **Z.A. K (bashkëshort i ankueses, znj.M. K)** është përfitues sipas VKB nr.44 prot., datë 06.07.2016 për “Përzgjedhjen e listës së aplikuesve përfitues të programit të banesave

⁴ Referuar proceverbalit të mbajtur me znj.Selviqe Maksuti.

sociale me qira, në zonën e Shkozës” me nr.rendor 28 të kësaj liste, me të ardhura të vetëdeklaruarra janë 19 536 lekë. Vlera e qirasë së apartamentit të përfituar, miratuar nga Këshilli Bashkiak është 15.680 lekë, nga të cilat 7 840 lekë i subvencionon Bashkia Tiranë dhe banori detyrohet të paguajë pjesën e mbetur të qirasë së përllogaritur, konkretisht në vlerën 7 840 lekë. Këto të dhëna specifikohen në kontratën individuale me nr.6 prot., datë 26.07.2016 lidhur mes z.A. K dhe DPN3. Referuar të ardhurave të vetëdeklaruarra të z.Kurti për vitin 2017 të cilat kanë qenë 22 000 lekë, vlerësojmë se të ardhurat e tij kanë ndryshuar duke pësuar rritje prej 2 464 lekësh. Pra, nga sa shihet z.K nuk ka pësuar ulje të të ardhurave, krahasuar me vitin 2016, vit ku ka lidhur kontratën e qirasë, (bazuar në vetëdeklarimin e të ardhurave) dhe megjithatë referuar bilancit financiar rezulton se ai është debitor prej 13 muajsh në vlerën 101 920 lekë.

- **Z.Y. S (bashkëshort i ankueses znj.R. S dhe babai i ankuesit Gj. S)** është përfitues sipas VKB nr.28 prot., datë 13.08.2015 për “Përzgjedhjen e listës së aplikuesve përfitues të programit të banesave sociale me qira, në zonën e Shkozës” me nr.rendor 184 të kësaj liste, me të ardhura të vetëdeklaruarra janë 48 488 lekë. Vlera e qirasë së apartamentit të përfituar, miratuar nga Këshilli Bashkiak është 13.580 lekë, nga të cilat 1 458 lekë i subvencionon Bashkia Tiranë dhe banori detyrohet të paguajë pjesën e mbetur të qirasë së përllogaritur, konkretisht në vlerën 12 122 lekë. Këto të dhëna specifikohen në kontratën individuale me nr.14 prot., datë 01.09.2015 lidhur mes z.Y. S dhe DPN3. Referuar të ardhurave të vetëdeklaruarra të z.S për vitin 2017 të cilat kanë qenë 51 896 lekë, vlerësojmë se të ardhurat e tij kanë ndryshuar duke pësuar rritje prej 3 408 lekësh. Pra, nga sa shihet z.S. nuk ka pësuar ulje të të ardhurave, krahasuar me vitin 2016, vit ku ka lidhur kontratën e qirasë, (bazuar në vetëdeklarimin e të ardhurave) dhe megjithatë referuar bilancit financiar rezulton se ai është debitor prej 11 muajsh në vlerën 133 342 lekë.
- **Z.A. H** është përfitues sipas VKB nr.28prot., datë 13.08.2015 për “Përzgjedhjen e listës së aplikuesve përfitues të programit të banesave sociale me qira, në zonën e Shkozës” me nr.rendor 21 të kësaj liste, me të ardhura të vetëdeklaruarra janë 30 680 lekë. Vlera e qirasë së apartamentit të përfituar, miratuar nga Këshilli Bashkiak është 15.680 lekë, nga të cilat 7 840 lekë i subvencionon Bashkia Tiranë dhe banori detyrohet të paguajë pjesën e mbetur të qirasë së përllogaritur, konkretisht në vlerën 7 840 lekë. Këto të dhëna specifikohen në kontratën individuale me nr.26 prot., datë 01.09.2015 lidhur mes z.A. H dhe DPN3. Referuar të ardhurave të vetëdeklaruarra të z.H për vitin 2017 të cilat kanë qenë 36 373 lekë, vlerësojmë se të ardhurat e tij kanë ndryshuar duke pësuar rritje prej 5 693 lekësh. Pra, nga sa shihet z.H nuk ka pësuar ulje të të ardhurave, krahasuar me vitin 2016, vit ku ka lidhur kontratën e qirasë, (bazuar në vetëdeklarimin e të ardhurave) dhe megjithatë referuar bilancit financiar rezulton se ai është debitor prej 24 muajsh në vlerën 188 160 lekë.

- **Z.N. N (babai i ankueses znj.A. N)** është përfitues sipas VKB nr.28 prot., datë 13.08.2015 për “Përzgjedhjen e listës së aplikuesve përfitues të programit të banesave sociale me qira, në zonën e Shkozës” me nr.rendor 92 të kësaj liste, me të ardhura të vetëdeklaruara janë 35 417 lekë. Vlera e qirasë së apartamentit të përfituar, miratuar nga Këshilli Bashkiak është 15.680 lekë, nga të cilat 6 826 lekë i subvencionon Bashkia Tiranë dhe banori detyrohet të paguajë pjesën e mbetur të qirasë së përllogaritur, konkretisht në vlerën 8 854 lekë. Këto të dhëna specifikohen në kontratën individuale me nr.12 prot., datë 01.09.2015 lidhur mes z.N. N dhe DPN3. Referuar të ardhurave të vetëdeklaruara të z.N për vitin 2017 të cilat kanë qenë 34 415 lekë, vlerësojmë se të ardhurat e tij kanë ndryshuar duke pësuar ulje prej 1 002 lekësh. Pra, nga sa shihet z.N ka pësuar një ulje të të ardhurave, krahasuar me vitin 2016, vit ku ka lidhur kontratën e qirasë, (bazuar në vetëdeklarimin e të ardhurave) dhe referuar bilancit financiar rezulton se ai është debitor prej 21 muajsh në vlerën 338 373 lekë.

- **Z.N. Sh** është përfitues sipas VKB nr.28 prot., datë 13.08.2015 për “Përzgjedhjen e listës së aplikuesve përfitues të programit të banesave sociale me qira, në zonën e Shkozës” me nr.rendor 236 të kësaj liste, me të ardhura të vetëdeklaruara janë 40 155 lekë. Vlera e qirasë së apartamentit të përfituar, miratuar nga Këshilli Bashkiak është 15.680 lekë, nga të cilat 5 641 lekë i subvencionon Bashkia Tiranë dhe banori detyrohet të paguajë pjesën e mbetur të qirasë së përllogaritur, konkretisht në vlerën 10 039 lekë. Këto të dhëna specifikohen në kontratën individuale me nr.213 prot., datë 04.09.2015 lidhur mes z.N. Sh dhe DPN3. Referuar të ardhurave të vetëdeklaruara të z.Sh për vitin 2017 të cilat kanë qenë 15 485 lekë, vlerësojmë se të ardhurat e tij kanë ndryshuar duke pësuar ulje prej 24 670 lekësh. Pra, nga sa shihet z.Sh ka pësuar një ulje të të ardhurave, krahasuar me vitin 2016, vit ku ka lidhur kontratën e qirasë, (bazuar në vetëdeklarimin e të ardhurave) dhe referuar bilancit financiar rezulton se ai është debitor prej 26 muajsh në vlerën 261 014 lekë.

- **Z.B. M** është përfitues sipas VKB nr.44 prot., datë 06.07.2017 për “Përzgjedhjen e listës së aplikuesve përfitues të programit të banesave sociale me qira, në zonën e Shkozës” me nr.rendor 162 të kësaj liste, me të ardhura të vetëdeklaruara janë 33 000 lekë. Vlera e qirasë së apartamentit të përfituar, miratuar nga Këshilli Bashkiak është 18 620 lekë, nga të cilat 9 310 lekë i subvencionon Bashkia Tiranë dhe banori detyrohet të paguajë pjesën e mbetur të qirasë së përllogaritur, konkretisht në vlerën 9 310 lekë. Këto të dhëna specifikohen në kontratën individuale me nr.128 prot., datë 02.08.2016 lidhur mes z.B M dhe DPN3. Referuar të ardhurave të vetëdeklaruara të z.M për vitin 2017 të cilat kanë qenë 27 920 lekë, vlerësojmë se të ardhurat e tij kanë ndryshuar duke pësuar ulje prej 5 080 lekësh. Pra, nga sa shihet z.M ka pësuar një ulje të të ardhurave, krahasuar me vitin 2016, vit ku ka lidhur kontratën e qirasë, (bazuar në vetëdeklarimin e të ardhurave) dhe

referuar bilancit financiar rezulton se ai është debitor prej 15 muajsh në vlerën 139 650 lekë.

- **Z.Q. L (bashkëshort i ankueses znj.L. L)** është përfitues sipas VKB nr.2 prot., datë 13.08.2015 për “Përzgjedhjen e listës së aplikuesve përfitues të programit të banesave sociale me qira, në zonën e Shkozës” me nr.rendor 56 të kësaj liste, me të ardhura të vetëdeklaruar janë 68 552 lekë. Vlera e qirasë së apartamentit të përfituar, miratuar nga Këshilli Bashkiak është 18 620 lekë, nga të cilat 1 482 lekë i subvencionon Bashkia Tiranë dhe banori detyrohet të paguajë pjesën e mbetur të qirasë së përlllogarit, konkretisht në vlerën 17 138 lekë. Këto të dhëna specifikohen në kontratën individuale me nr.73 prot., datë 01.09.2015 lidhur mes z.L dhe DPN3. Referuar të ardhurave të vetëdeklaruar të z.L për vitin 2017 të cilat kanë qenë 30 000 lekë, vlerësojmë se të ardhurat e tij kanë ndryshuar duke pësuar ulje prej 38 552 lekësh. Pra, nga sa shihet z.L ka pësuar një ulje drastike të të ardhurave, krahasuar me vitin 2016, vit ku ka lidhur kontratën e qirasë, (bazuar në vetëdeklarimin e të ardhurave) dhe referuar bilancit financiar rezulton se ai është debitor prej 14 muajsh në vlerën 239 932 lekë.

Nga analiza e situatës së mësipërme së rezulton se subjektet ankues: **znj.M. K, znj.R. S, (z.Gj. S, i biri),z.A. H** nuk kanë pësuar ulje të të ardhurave, përkundrazi kanë pësuar rritje dhe përsëri nuk kanë paguar detyrimet. Pra, justifikimi se shkak për mospagesat e akumuluar në kohë është bërë rënia e të ardhurave ekonomike të tyre, nuk qëndron dhe është i pa bazuar.

Ndërsa, lidhur me subjektet ankues: **z.N. N, z.N. Sh, z.B. M dhe z.Q. L**, Komisioneri vlerëson se ndodhen në kushtet e rënies të të ardhurave ekonomike, çka në një farë mënyre justifikon pamundësinë e tyre financiare për të përmbushur detyrimet e pagesës së qirasë.

Komisioneri vlerëson se, situata e mospagesës së qirasë të banesës sociale nga ana e këtyre familjeve ka ardhur për arsye që lidhen me pamundësinë ekonomike për të paguar, si pasojë e rënies të të ardhurave mujore të tyre. Kjo pamundësi lidhet me një sërë rrethanash specifike. Kështu, citojmë se:

- Këto familje, në momentin e aplikimit për përfitimin e një banese sociale kanë bërë vetëdeklarimin e të ardhurave, bazuar në veprimtaritë ekonomike informale, siç ishte mbledhja e materialeve të riciklueshme.
- Mirëpo, pas veprimeve të ndërmarra nga Policia Bashkiake për ndalimin e mbledhjes së këtyre materialeve, si dhe ndalimit të përdorimit të automjeteve të modifikuara për transportin e mallrave, disa nga këto familje, duke mos mundur të ushtronin këto veprimtari janë gjendur në pamundësi për të përballuar shpenzimet e nevojshme të jetesës, ndër to dhe pagesën e qirasë së banesave sociale ku jetojnë.
- Theksojmë se, nga ana e Bashkisë Tiranë nuk janë sjellë prova apo dokumentacion ku të mund të provohet se nga ana e tyre është bërë paraprakisht një analizë e situatës mbi

vlerësimin e efekteve apo impaktit që do të kishin veprimet e ndërmarra nga ana e Policisë Bashkiake. Për më tepër, nuk është paraqitur asnjë plan konkret për krijimin dhe ofrimin e mundësive reale apo alternativave për punësimin e kësaj kategorie personash që ushtronin këtë aktivitet, qoftë ky dhe informal.

- Nga këqyrja e dokumentacionit të depozituar tek Komisioneri, rezulton se pjesa më e madhe e anëtarëve në moshë pune të këtyre familjeve figurojnë me statusin e punëkërkuesit të papunë, regjistruar pranë Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Kombëtar të Punësimit Tiranë. Komisioneri vlerëson se, si pasojë e varfërisë, përjashtimit social dhe mungesës së arsimimit dhe kualifikimeve përkatëse, shumica e romëve dhe egjiptianëve kanë vështirësi për t'u punësuar në tregun formal.
- Kjo situatë është e njohur nga qeveria shqiptare, e cila me VKM nr.1072, datë 23.12.2015 ka miratuar “Planin kombëtar të veprimit për integrimin e romëve dhe egjiptianëve në Republikën e Shqipërisë, 2016-2020”, ku citohet ndër të tjera se: *“Romët dhe egjiptianët përballen me barriera të drejtpërdrejta dhe të tërthorta në aksesin e shërbimeve publike, të cilat lindin nga kriteret e pranueshmërisë që ata nuk mund t'i plotësojnë, nga mungesa e informacionit ose nga moskuptimi i procedurave administrative, si dhe stigmatizimi dhe diskriminimi i vazhdueshëm nga pjesa tjetër e popullatës. Për shkak të periudhave të gjata të papunësisë dhe angazhimit të shpeshtë në punë informale dhe me pagë të ulët, familjet rome preken nga varfëria mbi dy herë më shumë se familjet jo rome që jetojnë në afërsi të tyre”*.
- Komisioneri vlerëson punën e Bashkisë Tiranë dhe veprimet e ndërmarra në favor të kësaj kategorie, në mënyrë që ata të mund t'i aksesojnë këto shërbime, por thekson nevojën e ndërhyrjeve më të kujdesshme sa i takon rishikimit të masës së subvencionimit të qirasë, për familjet që kanë njoftuar (dhe faktuar) se niveli i të ardhurave në familjet e tyre ka rënë. Komisioneri vlerëson se bazuar në nenin 12 të ligjit nr.9232, datë 13.05.2004 “Për programet sociale të strehimit”, i ndryshuar dhe në pikën 10.9 të kontratës së qirasë së banesës sociale, rrethanat sipërcituar përbëjnë arsye të justifikuara, të cilat duhet të merren në konsideratë nga Bashkia Tiranë në funksion të rinovimit të kontratës së qirasë së banesës sociale për këto familje.
- Komisioneri sjell në vëmendje të Bashkisë Tiranë se, në rrethana të tilla të pamundësisë ekonomike të këtyre familjeve, zgjidhja e mundshme e kontratës së qirasë së banesës dhe lirimi i saj, e cila do të sillte si pasojë humbjen e strehës për familjen, do të thellonte më tepër krizën social-ekonomike të tyre.
- Të gjitha këto familje plotësojnë kushtet e parashikuara në nenin 5 të ligjit nr.9232/2004 “Për programet sociale të strehimit”, i ndryshuar, për t'u përzgjedhur si përfituese të banesave sociale, për shkak të kushteve të vështira social-ekonomike të tyre. (Pikërisht për këto arsye dhe janë përzgjedhur si përfituese nga ana e Bashkisë Tiranë). Aq më tepër tani që janë në kushtet e përkeqësimit të kushteve të tyre ekonomike.
- Komisioneri vlerëson vullnetin e Bashkisë Tiranë që familjet të cilat janë të detyruara të lirojnë banesat sociale për shkak të detyrimeve të bartura, mospagesës, t'i përfshijë në

programin social të bonusit të strehimit, mbështetje deri në masën 100%, në varësi të rastit. Mirëpo, gjykon se nga ana tjetër, kjo masë do të cënonte stabilitetin e familjes të sistemuar tashmë në këto banesa prej dy a më shumë vitesh. Kjo për arsyen se familja që i ofrohet pagesa e qirasë së banesës në tregun e lirë, do të përballej me një sërë problematikash të tjera për sigurimin e një banese tjetër me qira në treg të lirë, në formën e diskriminimit të fshehur, gjë që mund të supozojmë se do sillte vështirësi në rivendosjen nga e para të marrëdhënieve për aksesin e shërbimeve publike në zonën e re ku do të zhvendoseshin. Këto familje, potencialisht rrezikojnë të mbeten të pastrehë për shkak të pamundësisë ekonomike për të paguar qiranë e banesës sociale ku ata jetojnë. Lidhur me këtë problematikë, Komisioneri vlerëson se Bashkia Tiranë duhet të fokusohet në gjetjen e një zgjidhjeje të përshtatshme dhe të qëndrueshme në kohë, për familjet në pamundësi ekonomike në mënyrë që këto familje të mund të krijojnë të ardhura të qëndrueshme dhe të mjaftueshme për jetesë, si dhe të përbushin detyrimet kontraktore kundrejt Bashkisë Tiranë.

- Komisioneri gjykon se, Bashkia Tiranë, duhet të bëjë sa më shpejt të jetë e mundur një rivlerësim të situatës social-ekonomike për këto familje, në funksion të përcaktimit të masës së subvencionimit të qirasë së ofruar nga ana e këtij institucioni; duke e shoqëruar me marrjen e një plani masash integruese në tregun e punës, gjë që do të ndikonte në aspektin financiar të familjeve përfituese.

Ligji nr.9232/2004 “Për programet sociale të strehimit”, i ndryshuar, në kreun VII “Ndihma e shtetit”, në nenin 24 të tij përcakton se: *“1. Kur qiraja e banesës sociale zë më shumë se 25% të ardhurave neto të familjes, kjo e fundit përfiton subvencion të qirasë. **Shuma e subvencionimit të llogaritet e barabartë me diferencën ndërmjet qirasë së synuar dhe asaj të përballueshme.** 2. Kategoritë që kanë përparësi në subvencionimin e qirasë ose përfitimin e bonusit të strehimit janë:dh) familjet e komunitetit rom ”.*

Vlerësimi dhe verifikimi i gjendjes ekonomike dhe sociale të familjeve realizohet në përputhje me përcaktimet e nenit 28 dhe 29 të ligjit nr.9232/2004 “Për programet sociale të strehimit”. Kështu, neni 28 “Mënyra e verifikimit” përcakton se: “1. Ndihma e shtetit bazohet në verifikimin e gjendjes ekonomike e financiare të familjes. 2. Verifikimi i gjendjes ekonomike të familjes kryhet nga administratorët shoqërorë të zyrave të ndihmës ekonomike, sipas procedurave të miratuara në udhëzimin e përbashkët të ministrit që mbulon fushën e strehimit dhe të ministrit që mbulon çështjet sociale”.

Neni 29 “Ankimimi” i po këtij Ligji përcakton se: *“Pas verifikimit nga administratorët shoqërorë, zyrat përkatëse të bashkisë njoftojnë zyrtarisht familjen për rezultatet e verifikimit të gjendjes ekonomike. Kundër vendimit të administratorëve, familja ka të drejtë të ankohet pranë Këshillit Bashkiak brenda 10 ditëve dhe të kërkojë një rivlerësim të dytë. Vendimi i rivlerësimit jepet nga Këshilli Bashkiak dhe është i formës së prerë. Në vendim përcaktohet forma e strehimit të familjes”.*

- Lidhur me njoftimin publik për lirimin e banesave në rast të mos shlyerjes së detyrimeve, Komisioneri vlerëson që përpara se të ndërmerren veprime të tilla, Bashkia Tiranë të bëjë një analizë paraprake të situatës dhe një vlerësim të gjendjes sociale, nevojave dhe të ardhurave ekonomike të këtyre familjeve; dhe në përfundim të analizimit të këtyre të dhënave, të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme, për të evituar që këto familje të mbeten të pastreha apo ekspozohen dhe më tej ndaj shkeljeve të tjera të të drejtave të njeriut, çka do të çojë në diskriminim të tyre për shkak të gjendjes ekonomike dhe racës së tyre, krahasuar me pjesën tjetër të familjeve që posedojnë një banesë sociale dhe që kanë aftësi paguese për qiranë mujore.
- Komisioneri vlerëson se Bashkia Tiranë duhet t’u sigurojë mundësi reale integrimi në tregun e punës, familjeve debitore që banojnë në banesat sociale me qira.
- Duke marrë për referencë praktikën pozitive të ndjekur nga Enti Kombëtar i Banesave në vitin 2016, Komisioneri i sugjeron Bashkisë Tiranë, të ndërveprojë me Drejtorinë Rajonale të Shërbimit Kombëtar të Punësimit Tiranë, me qëllim trajtimin me prioritet të punësimit të anëtarëve të familjeve të strehuara në banesat sociale me qira.
- Komisioneri vlerëson se lidhja e një akt-marrëveshjeje midis Bashkisë Tiranë dhe familjeve debitore, për likuidimin me këste të përballueshme të detyrimeve të prapambetura kontraktore, do t’u krijonte mundësi reale këtyre familjeve të shlyenin detyrimet e bartura dhe qiranë mujore në vijim dhe do të krijonte premisat për një mundësi integrimi konkrete të tyre.

Neni 3 i ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi” ka përcaktuar se: “ *“Diskriminim i drejtëpërdrejtë” është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një person apo grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, apo një grup personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji*”.

Parimi i barazisë para ligjit dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet t gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjisllacionin shqiptar si dhe të zbatohet nga të gjithë, si nga institucionet edhe nga individët.

Dinjiteti i njeriut është një vlerë themelore kushtetuese⁵. Një shoqëri demokratike, që bazohet në dinjitetin e njeriut dhe parimin e barazisë së gëzimit të të drejtave themelore nga të gjithë individët, duhet të garantojë plotësimin e nevojave bazike jetësore për të gjithë. Çdo individ është pjesë e një komuniteti shoqëror të caktuar dhe në këtë kontekst interpretohet edhe dinjiteti i njeriut, si një garanci themelore.

⁵Në Preambulën e Kushtetutës deklarohet: “*Pavarësia e shtetit dhe tërësia e territorit të tij, dinjiteti i njeriut, të drejtat dhe liritë e tij, drejtësia shoqërore, rendi kushtetues, pluralizmi, identiteti kombëtar dhe trashëgimia kombëtare, bashkëjetesa fetare, si dhe bashkëjetesa dhe mirëkuptimi i shqiptarëve me pakicat janë baza e këtij shteti, i cili ka për detyrë t’i respektojë dhe t’i mbrojë*”.

Sipas nenit 116 të Kushtetutës, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara me ligj, në hierarkinë e normave juridike renditen menjëherë pas Kushtetutës. Për pasojë, ato zënë një vend të rëndësishëm në të drejtën e brendshme e bëhen të detyrueshme për t'u zbatuar për çdo shtet, për të gjithë organet shtetërore. Shqipëria ka nënshkruar e ratifikuar disa akte ndërkombëtare, që në thelb kanë të bëjnë me trajtimin e barabartë, mosdiskriminimin, mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në përgjithësi.

Neni 14, i KEDNJ, "Ndalimi i diskriminimit", përcakton se : *"Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër"*.

Theksojmë se, e drejta për mbrojtjen nga diskriminimi përfshin jo vetëm detyrimin e trajtimit të barabartë të personave në situata të njëjta, por dhe trajtimin ndryshe të personave në situata të ndryshme.

Në çështjen Thlimmenos kundër Greqisë, GjEDNJ ka mbajtur qëndrimin se: *"...kemi një diskriminim kur shteti pa një argumentim objektiv dhe racional e refuzon trajtimin e diferencuar të personave, situata etë cilëve është tepër e ndryshme"*. Sipas jurisprudencës së GJEDNJ-së, një hapësirë e gjerë i është dhënë shtetit për të marrë masat e duhura për politikën sociale. Ligjvënësi, në funksion të detyrimit kushtetues për realizimin e objektivave socialë, duhet të mbajë parasysht nocionin e një bërthame minimale të të drejtave dhe lirive të njeriut.

Në rastin në shqyrtim, ligjvënësi ka përcaktuar se, Autoritetet përgjegjëse të institucioneve që ofrojnë shërbime për publikun, pra Bashkia e Tiranës në rastin konkret, ka detyrim të krijojë mundësitë për lehtësimin e kushteve për të mundësuar që këto familje të jenë pagues të rregullt të qirave të këtyre banesave, si dhe të hartojë projekte të reja për shërbime dhe banesa sociale me qira, ku të parashikohen me prioritet të gjitha masat dhe kushtet e domosdoshme për të bërë të realizueshme në realitet përmbushjen e detyrimit të këtyre familjeve për pagesën e qirasë së banesave sociale.

Për shkak se ky program strehimi është i dedikuar vetëm për familjet që kanë mundësi pagese (gjë që pasqyrohet dhe në kontrastin e qirasë), familjet e gjendura në pamundësi pagese të qirasë për shkak të rënies të të ardhurave të tyre ekonomike, janë vënë në pozita të pafavorshme dhe të pabarabarta me familjet që kanë mundësi pagese. Mos parashikimi i një praktike aktuale rivlerësimi, në kushtet e reja, pas përkeqësimit të situatës së tyre financiare nga ana e Bashkisë Tiranë, i vë ata në pozita diskriminuese duke rrezikuar që ata të mbeten të pastrehë. Rivlerësimi objektiv i situatës, shoqëruar me rritjen e masës së subvencionimit të qirasë së banesës sociale nga ana e Bashkisë Tiranë, rast pas rasti, si dhe me masa të tjera integruese, do të rrisnin mundësinë që pagesat e qirasë të ishin të realizueshme. Kjo do të ndikonte pozitivisht në qasjen konkrete social ekonomike të këtyre familjeve në shoqëri

PËR KËTO ARSYE :

Në bazë të nenit 12, pika 1, germa c), nenit 32, gërma c), si dhe nenit 33, pikat 10, 11, të Ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi” Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e mosdiskriminimit, të subjekteve ankues: **znj.M. K, znj.R. S, (z.Gj. S, i biri), z.A. H,** nga ana e Bashkisë Tiranë, për shkak të “gjendjes së tyre ekonomike” dhe “të racës”.
2. Konstatimin e diskriminimit të drejtëpërdrejtë, të subjekteve ankues: **z.N. N, z.N. Sh, z.B. M dhe z.Q. L,** nga ana e Bashkisë Tiranë, për shkak të “gjendjes së tyre ekonomike” dhe “të racës”.
3. Në referim të pikës 2, Bashkia Tiranë, si subjekt që ka konsumuar sjelljen diskriminuese ndaj këtij grupi personash, të bëjë rivlerësimin e masës së subvencionimit të qirasë së banesës sociale, të paguar nga Bashkia.
4. Në referim të nenit 33, pika 11, të Ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijani për këtë vendim, Bashkia Tiranë, të njoftojë Komisionerin, lidhur me masat e marra për zbatimin e tij.
5. Moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë sipas parashikimeve të bëra në pikën 13 të po këtij neni.
6. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në gjykatë, brenda afateve ligjore.

Irma BARAKU

KOMISIONERI

(shkaku: gjendja ekonomike, raca)
(fusha: të mira dhe shërbime)